

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zotit Besnik Dervishi

Lënda: Paraqitje ankimi ndaj Bashkisë Tiranë.

Datë: 25.05.2021

I nderuar zoti Komisioner për të Drejtën e Informimit.

Albanian Institute of Science (AIS) është një organizatë jo fitimprurëse e njohur si promotore e informacionit transparent përmes Open Data Albania.

Në datën 06 Maj 2021, AIS ka paraqitur në Bashkinë e Tiranës kërkesë për informim për dokumenta zyrtare të tilla si Lista Emërore me Përfitues nga Fonde Publike si Anekse dhe Bashkëlidhje në Vendimet e Këshillit Bashkiak (VKB), të renditura me më poshtë. Këto Lista nuk janë të publikuara online në faqen zyrtare web të Bashkisë, apo në Rubrikën për Publikim të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Tiranë.

Konkretisht Bashkisë së Tiranës i është kërkuar:

- Bashkëlidhje Aneks shoqërues. Pjesë e VKB Nr. 66, datë 19.04.2021 “Për Miratimin e Listës së Përfituesve nga Programi i Grantit të Rindërtimit”. Ky aneks ka përmbajtje subjekte që përfitojnë vlerat e grantit të rindërtimit të parashikuara në vendimin Nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, të ndryshuar.
- Bashkë Lidhje Aneks Shoqëruese pjesë e VKB Nr. 65 “Për miratimin e listës së përfituesve të nënprogramit të grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4”. Ky aneks ka emra Subjektet përfitojnë vlerën e rikonstruksionit sipas parashikimeve të vendimit Nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga Aktekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, të ndryshuar.
- Bashkëlidhje Dy Anekse Shoqëruese pjesë e VKB Nr. 64, datë 19.04. 2021”Për miratimin e Listës së Përfituesve nga Granti i Rikonstruksionit” dhe për disa ndryshime në Vendimet e Listave të Përfituesve nga ky Nënprogram. Këto anekse kanë Lista emërore të subjekteve përfituese nga granti i rikonstruksionit, sipas kategorive të dëmit DS1, DS2. dhe DS3.

- Bashkëlidhje Katër anekse shoqëruese të VKB Nr. 63, datë 19.04.2021 “Për miratimin e Listës së Përfituesve nga Programi i Zhvillimit të Objekteve të Reja në Njësinë Administrative nr. 6 Baldushk, Ndroq dhe Pezë”. Këto anekse kanë të miratuar lista emërore me subjekte përfituese nga programi i zhvillimit të objekteve të reja në njësinë Administrative Nr. 6. Baldushk, Ndroq dhe Pezë.
- Lista emërore me Korrigjime për VKB Nr. 61, datë 6.04.2021 “Për disa Korrigjime gabimi material në vendimet e listave të përfituesve nga granti i rikonstruksionit dhe programi i Rindërtimit”.
- Bashkëlidhje Aneksin shoqërues të VKB Nr. 16, datë 01.03.2021 “Për miratimin e Listës së Përfituesve nga Granti i Rikonstruksionit”. Lista e Miratuar sipas kategorive të dëmit DS1, DS2 dhe DS3 listën emërore të subjekteve përfituese nga granti i rikonstruksionit sipas aneksit 1 bashkëlidhur dhe me pjesë përbërëse të Vendimit.
- Bashkëlidhje Aneks shoqërues i VKB Nr. 17, datë 01.03.2021 “Për miratimin e Listës së Përfituesve nga Programi i Zhvillimit të Objekteve të reja në Njësinë administrative nr. 6”.
- Bashkëlidhje Aneks shoqërues i VKB Nr. 7, datë 13.02.2021 “Për Miratimin e listës së Përfituesve të nënprogramit të Grantit të Rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara nga Instituti i ndërtimit me nivel dëmi DS4”. Aneksi ka të miratuar listë e përfituesve të nënprogramit të grantit të rikonstruksionit banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara nga Instituti i Ndërtimit me nivel dëmi DS4.
- Bashkëlidhje Dy lista Anekse të lidhura ne VKB Nr. 8, datë 13. 02. 2021 “Për miratimin e Listës së Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit”. Këto dy anekse kanë përmbajtje emra të subjekteve përfituese të përcaktuara në Aneks Nr. 1 të pikës 2 që përfitojnë vlerat e grantit të rindërtimit të parashikuara në Vendimin Nr. 160 datë 7.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e Vlerave për Përfituesit e grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertiza e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS 4dhe DS 5 të ndryshuar”.
- Bashkëlidhje Aneks që shoqëron VKB Nr. 6, datë 13.02.2021 “Për Miratimin e Listës së Përfituesve nga granti i Rikonstruksionit”. Me këtë aneks është miratuar Lista Emërore e Subjekteve përfituese nga granti i rikonstruksionit sipas kategorive të Dëmit DS1, DS2 dhe DS3.

Bashkia e Tiranës nëpërmjet shkresës nr. A-9928/2 prot., datë 18.05.2021 i ka kthyer përgjigje AIS se “*nuk mund të vendosë në dispozicion emrat e përfituesve të këtyre fondeve sepse listat e cituara në vendimet e Këshillit Bashkiak që janë bashkëlidhur si anekse në këto vendime përmbajnë të dhëna personale të përfituesve si numër identifikimi, të dhëna mbi përfitimin ekonomik, etj. të cilat mbrohen nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” sipas nenit 3 pika 1 e tij...*”

Vendimin administrativ të sipërcituar të Bashkisë së Tiranës e konsiderojmë si akt që është në kundërshtim me ligjin në fuqi nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në mbështetje të nenit 24 të këtij ligji paraqesim këtë ankesë para jush.

Në analizën ligjore dhe ligjshmërinë e kërkesës sonë dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj një vendim të rëndësishëm të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e cila është gjykata më e lartë e Bashkimit European. Gjykata Europiane e Drejtësisë ka shqyrtuar në thellësi çështjen e parimit të transparencës - të mishëruar në të drejtën për informim në dokumentet zyrtare - dhe raportin e saj

me mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë çështje gjyqësore (*Judgment of the Court (Grand Chamber) of 9 November 2010. Volker und Markus Schecke GbR (C-92/09) and Hartmut Eifert (C-93/09) v Land Hessen*) kjo Gjykatë morri në shqyrtim dhe vendosi për faktin nëse publikimi në internet i emrave të përfituesve nga fondet e Bashkimit Europian në fushën e bujqësisë përbënte cënim të jetës së tyre private sepse bëhen publike të dhëna personale të përfituesve të fondeve.

Gjykata Europiane e Drejtësisë ¹ në vendimin e saj vendosi se:

“68. Parimi i transparencës përcaktohet në nenet 1 TEU dhe 10 TEU (Traktati i Bashkimit Europian) dhe në nenin 15 TFEU (Traktati për funksionimin e Bashkimit Europian). Kjo u mundëson qytetarëve të marrin pjesë sa më afër në procesin e vendimmarrjes dhe garanton që administrata gëzon një legjitimitet më të madh dhe është më efektive dhe më e përgjegjshme për qytetarin në një sistem demokratik (shih Çështjen C 41/00 P *Interporc v Komisionit* [2003] ECR I 2125, paragrafi 39 dhe Çështja C 28/08 P *Komisioni kundër Bavaria Lager* [2010] ECR I 0000, paragrafi 54).

69. Duke përforcuar kontrollin publik të përdorimit të parave nga EAGF (European Association for Flower Growers) dhe EAFRD (The European Agricultural Fund for Rural Development) botimi i kërkuar nga dispozitat vlefshmëria e të cilave kontestohet, kontribuon në përdorimin e duhur të fondeve publike nga administrata (shih, për këtë qëllim, *Österreichischer Rundfunk dhe të tjerët*, paragrafi 81).

70. Për më tepër, ky publikim në lidhje me përdorimin e parave të paguara nga fondet bujqësore do t'u mundësojë qytetarëve të marrin pjesë më nga afër në debatin publik për vendimet mbi drejtimin që duhet të merret nga CAP (fondet e BE).

71. Si rrjedhojë, duke synuar rritjen e transparencës së përdorimit të fondeve në kontekstin e CAP, neni 44a i Rregullores Nr. 1290/2005 dhe Rregullorja Nr. 259/2008 ndjekin një objektiv me interes të përgjithshëm të njohur nga Bashkimi Evropian.....

74. Është praktikë gjyqësore e konsoliduar që parimi i proporcionalitetit, i cili është një nga parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit Evropian, kërkon që masat e zbatuara nga aktet e Bashkimit Evropian të jenë të përshtatshme për arritjen e objektivit të ndjekur dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për ta arritur atë (Çështja C 58/08 *Vodafone dhe të tjerët* [2010] ECR I 0000, paragrafi 51 dhe praktika gjyqësore e cituar).

75. Nuk diskutohet që publikimi në internet i të dhënave me emër në lidhje me përfituesit në fjalë dhe shumat e sakta të marra prej tyre nga EAGF dhe EAFRD mund të rrisin transparencën në lidhje me përdorimin e ndihmës bujqësore në fjalë. Një informacion i tillë i vënë në dispozicion të qytetarëve përforcon kontrollin publik të përdorimit në të cilin vendosen ato para dhe kontribuon në përdorimin më të mirë të fondeve publike.”

Në vlerësojmë se i njëjti arsyetim dhe vlerësim duhet të përdoret në shqyrtimin edhe të çështjes konkrete që paraqesim para jush.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit në një sërë vendimesh ka theksuar se “Ligji “Për të drejtën e informimit” ka për qëllim të nxisë forcimin e integritetit, transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike. Njësitë e qeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të kreut VI, të

¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:62009CJ0092>

ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe konkretisht neni 15 - transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore - që parashikon se: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre”

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar: “3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.”

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe të llogaridhënies, si një shtyllë themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.” (Vendim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit nr. 1, datë 15.02.2019).

Vetë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton se:

Neni 15

Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.

Neni 18

Seancat e këshillimeve me bashkësinë

3. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtim” përcakton se:

“4. Përfshirja në programet e rindërtimit bëhet nëpërmjet aplikimit në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku individi/familja ka vendbanimin, sipas modelit dhënë në shtojcën A, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe sipas deklaramit tip për vërtetësinë e të dhënave, dhënë në shtojcën B, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Aplikimi paraqitet drejtpërdrejt në strukturën/at përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose në zyrën e qëndrimit me një ndalesë të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rast se ka një të tillë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin që këto kërkesa të paraqiten pranë njësive administrative ku individët kanë vendbanimin.

7. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore krijojnë, administrojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe për plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit.

8. Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si më poshtë vijon:

- a) emrin, atësinë, mbiemrin;

- b) numrin e kërkesës;
- c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;
- ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit;
- d) adresën e kërkesit;
- dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit;
- e) Aktin e konstatimit/aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme;
- ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt për fitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.”

Informacioni dhe anekset e vendimeve të këshillit bashkiak të kërkuara prej AIS, sipas ligjit, duhet të jenë publike sa kohë që ato informojnë mbi shpërndarjen te parave publike, para të taksapaguesve tek individ përfitues dhe njëkohësisht janë pjesë përbërëse e vendimeve të këshillit bashkiak që duhet të publikohen. Parimi i transparencës është parim themelor për shtetin e së drejtës në Shqipëri dhe është evidentuar si i tillë nga vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Nëpërmjet transparencës së vendimmarrjes - në rastin konkret të Këshillit Bashkiak të Tiranës – qytetarëve, opinionit publik dhe OJF-ve iu jepet mundësia të marrin pjesë sa më afër në procesin e vendimmarrjes dhe njëkohësisht garantohet në këtë mënyrë një legjitimitet më i madh i administratës, një administratë më efektive dhe më e përgjegjshme për qytetarin në një sistem demokratik. Publikimi i listës së përfituesve domosdoshmërisht kontribuon në përdorimin e duhur dhe sipas ligjit të fondeve publike nga administrata e Bashkisë Tiranë. Për më tepër, publikimi do t'u mundësojë qytetarëve, opinionit publik dhe OJF-ve të marrin pjesë sa më afër në debatin publik për rindërtimin dhe në zvogëlimin e mundësisë së shpërdorimit të fondeve publike në këtë proces.

Publikimi i listës së përfituesve të kërkuar nga AIS respekton parimin e proporcionalitetit sipas të cilit masat e zbatuara nga administrata të jenë të përshtatshme për arritjen e objektivit të ndjekur dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për ta arritur. Pa dyshim që publikimi i emrave dhe shumave të sakta të përfituara me vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës rrit transparencën në lidhje me përdorimin e ndihmës dhe fondeve shtetërore në eliminimin e pasojave të tërmetit. Një informacion i tillë i vënë në dispozicion të publikut të gjerë përforcon kontrollin publik të përdorimit në të cilin vendosen ato para dhe kontribuon në përdorimin më të mirë të fondeve publike.

Nga ana tjetër, një element i shtuar i detyrimit për transparencë të plotë të përdorimit të këtyre fondeve është edhe fakti se këto janë vendime të marra nga këshilli bashkiak Tiranë në periudha dhe data të parashikuara si data zgjedhore për Procesin Zgjedhor 25 Prill 2025, dhe kjo çështje financimi të drejtpërdrejte për individë është çështje e ditës në diskutimin publik këto kohë.

Në përfundim, mbështetur në faktet dhe rrethanat e parashtruara, bazën ligjore dhe analizën e sipërcituar paraqesim kërkesën para Komisionerit për të Drejtën e Informimit:

“- Pranimin e ankesës së AIS ndaj autoritetit publik Bashkia Tiranë.

- Urdhërimin e autoritetit publik Bashkia Tiranë të vërë në dispozicion të AIS informacionin e kërkuar me vendime të Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe të të gjithë ankeseve të bashkëlidhura këtyre vendimeve, sipas objektit të kërkesës së AIS të paraqitur në datën 6 Maj 2021.

Duke shprehur konsideratën më të lartë,

Aranita Brahaj

Drejtore Ekzekutive

Adresa: Rr "Asim Vokshi"
Pallati 13/25 Kati 3
Tiranë.
Email: aranita.brahaj@ais.al

Bashkëlidhur:

- Kopje e kërkesës së AIS drejtuar Bashkisë Tiranë
- Përgjigje e Bashkisë Tiranë, datë 18.05.2021.